



**SHOQATA E NDERTUESVE TE SHQIPERISE**  
**ALBANIAN CONSTRUCTORS ASSOCIATION**  
Miratuar me Vendim Nr. 38 date 12.10.2001 te Gjykares se Tiranes  
Llogaria bankare, Banka Kombetare Tregtare, Dega 2, Tirane, Nr. 402002214

Nr. Prot. 126

Tiranë më, 11/092023

*Lënda: Rishikimi i strategjive që po orientojnë në rritjen e barrës fiskale dhe tatimore të sektorit të ndërtimit.*

**SH. T. Z. EDI RAMA**  
**KRYEMINISTËR**

**ZNJ. BELINDA BALLUKU**  
**ZËVENDËS KRYEMINISTËR**

**&**

**MINISTRE E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**Z. ERVIN METE**  
**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**ZNJ. DELINA IBRAHIMAJ**  
**MINISTRE SHTETI PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMEN E BIZNESIT**

Të nderuar,

Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, themeluar me Vendimin Nr. 38 datë 12.10.2001 të Gjykatës së Tiranës, me anë të kësaj shkrese pëcjell shqetësimin mbi disa çështje si më poshtë parashtruar, dhe besojmë se përfaqësojmë interesat e të gjithë aktorëve të cilët kontribuojnë në sektorin e ndërtimit.

Sektori i ndërtimit në Shqipëri zë një peshë prej më shumë se 10% në PBB, vlerë të cilës, në një kontekst më të gjerë duhet t'i shtohet edhe kontributi i dhënë në aktivitetet e pasurive të paluajtshme, rritjen e kapacitetit pritës në sektorin turistik si dhe krijimin e infrastrukturës së rrugore dhe portale, ku vlen të përmendet se një pjesë e mirë e investimeve po kryhet në terma koncesionar dhe ku pesha e investimit fillestar përballohet nga sektori privat.

Në mbështetje të strategjisë së zhvillimit të turizmit dhe infrastrukturës, nga ana e qeverisë janë marre masa të ndryshme duke ofruar ulje të barrës tatimore me synimin për të stimuluar investimin privat në këtë drejtim. Nga ana tjetër, në *terma anakronik*, në pesë vitet e fundit janë miratuar dhe propozuar vetëm nisma ligjore të cilat prodhojnë rritje kostosh të ndërtimit në sektorin civil ose edhe kosto për gëzimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, ndër të cilat më domethënëse janë:



**SHOQATA E NDERTUESVE TE SHQIPERISE**  
**ALBANIAN CONSTRUCTORS ASSOCIATION**

Miratuar me Vendim Nr. 38 date 12.10.2001 te Gjykates se Tiranes  
Llogaria bankare, Banka Kombetare Tregtare, Dega 2, Tirane, Nr. 402002214

- Ligji nr. 95/2018, datë 03.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore ( i ndryshuar);
- Ligji Nr. 22/2018. Për Strehimin Social (i ndryshuar);
- Projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”;
- Projektligji “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 26.7.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 873, datë 27.12.2022 “Për përcaktimin e kushteve dhe elementeve të përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale të projektuesit, të grupit të projektimit dhe zbatuesit të punimeve, si dhe rregullat dhe elementet e sigurimit, të përgjegjësisë së zhvilluesit për të gjitha ndërtimet me vlerë mbi 100 milionë lekë”;

Theksojmë se, nismat ligjore të sipërpërmendura, jo vetëm që rrisin koston e investimit që duhet të përballojë ndërtuesi dhe që rrjedhimisht përkthehet në një rritje çmimi me të cilin produkti ndërtimor do të hidhet në treg për blerësin, por në të njëjtën kohë rrisin edhe koston e zotërimit të pasurisë së paluajtshme për vetë blerësin, duke kontribuar sërish në rritje të çmimit në kurriz të blerësin.

Në veçanti Projektligji “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme”, paraqet edhe rrezikun e stimulimit të informalitetit në transaksionet e rishitjes së pasurive të paluajtshme nga individët.

Ne vijim do t’ju parashtojmë dhe çështjet, të cilat në këndvështrimin tonë përmbajnë problematika shumë të forta, jo vetëm për faktin që ngarkojnë sektorin tonë të sipërmarrjes me barra shumë të larta financiare, por edhe sepse aktet ligjore dhe nënligjore tentojnë të tejkalijnë garancitë që ofron kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë për të siguruar të drejta të barabarta në sipërmarrje.

Në një analizë të detajuar, ju parashtrojmë problematikat si në vijim:

***1. Rishikimi i çmimit të referencës të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”***

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 26.7.2023, është rishikuar tabela e çmimeve referuese të shitjes në treg të pasurive të paluajtshme të llojit ndërtesa në rang bashkish, VKM e cila si funksion primar ka përlllogaritjen e taksës së ndërtesës të parashikuar në Ligjin “Për taksat dhe tarifat vendore”.

Në kushtet ku VKM-ja nr. 457 ka hyrë në fuqi me publikimin në Fletore Zyrtare nr. 112 në datë 28.07.2023, për zonat ku është rritur çmimi i referencës, ndryshimi do të jap një efekt të menjëhershëm në financat e individëve dhe subjekteve juridik, pronar të pasurive të paluajtshme.



Por njëkohësisht, çmimet e referencës të parashikuara në këtë VKM, gjejnë përdorim për përcaktimin e çmimit të referencës për efekte të aplikimit të taksës për kalimin e pronësisë të parashikuar në Ligjin “Për të ardhurat”, duke dhënë kështu një impakt të menjëhershëm mbi individët që do të kryejnë transaksione me pasuri të paluajtshme, përfshirë edhe ata që kanë kryer rishtazi rivlerësimin sipas Ligjit nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

Gjithashtu, theksojmë se, ndryshmi i çmimeve të referencës sipas këtij Vendimi, jep një impakt të menjëhershëm edhe mbi aktivitetin e ndërtimit, duke qenë se këto çmime shërbejnë si faktor kryesor për përcaktimin e vlerës së taksës në infrastrukturë dhe në vlera monetare zëvendësuese e taksës 3% të kontributit në strehimin social (sipas praktikës të adaptuar nga Bashkia Tiranë me VKB nr. Nr.105, datë 25.10.2019) dhe për pasojë edhe mbi Tatim Fitimin.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, kanë lindur problematika në lidhje me projektet që shoqëritë e ndërtimit kanë në zbatim, duke krijuar nevojën për rishikim të planeve të biznesit dhe nevojave të reja për financim.

## **2. Kontributi për Strehimin Social**

Një shqetësim serioz për sektorin e ndërtimit përben edhe *kontributi i sektorit privat* (i kufizuar vetëm në sektorin e ndërtimit) në strehimin social në masën prej 3% të sipërfaqeve funksionale ndërtimore në pronësi të investitorit/zhvilluesit, për të cilin parashtojmë:

- Ky kontribut është bërë i detyrueshëm me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”. Pavarësisht terminologjisë “*kontribut*”, që në etimologjinë e gjuhës shqipe njësohet me parimin e vullnetarizmit, në rastin e ligjit në fjalë, kemi të bëjmë me një detyrim kontributiv me karakter fiskal, i parashikuar për tu dhënë vetëm në natyrë.
- Në parim, detyrimi kontributiv me karakter fiskal ka qëllim të ofrojë ndihmë sociale nga shtresa prodhuese e shoqërisë për një problem specifik të shtresave më në nevojë të shoqërisë. Në raste të veçanta, referuar sektorëve të veçanta të shoqërisë ose të industrisë, skema kontributeve konceptohet si një kompensim shkak -pasojë (psh. Kontribut shtesë për sigurimin e jetës së minatorëve të paguar nga subjektet minerare), por në rastin konkret të strehimit social, sektori i ndërtimit nuk mund të konsiderohet kurrësi se gjendet në termat e shkak-pasojë pasi është pikërisht ky sektor që prodhon asetet që do të nevojiten për zbutjen e plagës sociale.
- Kushtetuta e RSh dhe Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” ja ngarkojnë detyrën e zbutjes së plagës së strehimit qeverisë, por gjykojmë se ndarja e bërë nga qeveria është në mënyrë të pabarabartë dhe një peshë e rëndë për tu përballuar vetëm nga sektori privat, më saktë vetëm nga një sektor specifik.
- Gjithashtu, ndryshe nga taksa dhe tatime të tjera që aplikohen mbi qarkullimin e transaksioneve dhe kapitaleve që synojnë të kontribuojnë drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit pa specifikuar një përdorim të veçantë, kontributi privat për strehimin social, edhe po ta pranoni si një detyrim të drejtë, duhet të shoqërohet me një plan kohor dhe objektiv buxhetor, për të përballuar një sasi të numërueshme rastesh të shtresës në



**SHOQATA E NDERTUESVE TE SHQIPERISE**  
**ALBANIAN CONSTRUCTORS ASSOCIATION**

Miratuar me Vendim Nr. 38 date 12.10.2001 te Gjykates se Tiranes  
Llogaria bankare, Banka Kombetare Tregtare, Dega 2, Tirane, Nr. 402002214

nevojë, në pamundësi absolute për të financuar blerje banese, pra duhet të ishte një kontribut me afat të caktuar.

- Gjithashtu, edhe skema e mbledhjes se kontributit bazuar vetëm në lejet e ndërtimit të dhëna vetëm në natyrë prodhon efekt lokalizimi. Ligji nuk mban në konsideratë dinamikën e tregut të pasurive të paluajtshme. Kërkesat e tregut i kanë orientuar zhvilluesit në zbatimin e projekteve që synojnë target grupe të ndryshme klientësh, duke ju përshatur të ardhurave të klientëve. Në këtë formë, jo vetëm që tregu krijon variacione në çmimin e sipërfaqeve ndërtimore, por ndikon edhe në çmimet e shërbimeve që ofrohen përgjatë këtyre zhvillimeve. Psh: Kostot e administrimit të bashkëpronësisë variojnë mbështetur në gamën e shërbimeve që ofron vetë godina. Pra kostot e jetesës që ofrohen në disa objekte, nuk përputhen me mundësitë e personave që mund të përfitojnë nga skemat e strehimit social.
- Më tej, theksojmë se, volumi më i madh i investimeve në pasuri të paluajtshme shprehet në qytetet e mëdha dhe zonat bregdetare. Kushtëzimi që kontributi të kalohet në favor të pushtetit vendor në të cilin po merret leja, jo vetëm që zvogëlon mundësinë e bashkive më të vogla dhe zonave rurale e periferike për të përfituar nga ky kontribut, por në mënyrë indirekte bëhet një shtysë që njerëzit të lenë vendbanimet e tyre në zonat rurale/periferike, dhe ti drejtohen qendrave të mëdha.
- Një tjetër problematike e kontributit, është se barra e tij bie e tëra mbi investitorin, pavarësisht se e drejta e zhvillimit mund të bazohet në një marrëdhënie civile private ndërmjet zhvilluesve dhe pronarëve të truallit, ku këta të fundit përfitojnë sipërfaqe ndërtimore.

### 3. *Taksa e Ndikimit në infrastrukturë*

Tashmë prej vitesh taksa e ndikimit në infrastrukturë e parashikuar sipas Ligjit "Për taksat dhe tarifatat vendore" ka marrë më shumë trajtën e një haraçi sesa të një takse moderne që duhet të mbështesë dhënien e një shërbimi nga autoriteti përfitues kundrejt komunitetit dhe mbi të gjitha në drejtim të taksapaguesit. Në fakt kjo taksë, që duke nisur nga emërtimi i saj, të lë të mendosh se ka një objektiv dhe një qëllim mjaft të qartë, e cila është ajo e mbulimit të kostove që burojnë për integrimin me rrjetin ekzistues ose për krijimin e një rrjeti të ri infrastruktur kundrejtë objektit të ri ndërtimor, thuhet në asnjë moment të aplikimit të saj nuk është përdoruar për këtë qëllim. Konkretisht, janë gjerësisht vete ndertuesit ata që i zbatojnë me shpenzimet e veta

- a. punimet e infrastrukturës rrugore;
- b. trajtimin të ujërave dhe
- c. infrastrukturës energjetike

për të cilat më pas orvaten që këto objekte t'ua dhurojnë institucioneve përkatëse në mënyrë që të mos ngarkojnë kontabilitetin e shoqërive me asete jo prodhuese.

Përveç këtij paradoksi, ekzistuese që në gjenezën e taksës, është shtuar edhe dyfishimi ndër vite i shkallës tatimore si dhe metodologjia e llogaritjes (nga preventivi i punimeve në vlerën e çmimit të referencës së zonës) të cilat kanë rritur tejmasë peshën e kësaj takse në koston e çdo ndërtimi.



#### **4. Trajtimi i padrejtë i mbetjeve inerte**

Një problematike e vazhdueshëm për kostot e pajustificuara që përben për sektorin e ndërtimit, tashmë prej gati 10 vjetëve është praktika e krijuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575 date 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, sipas së cilave subjektet ndërtues detyrohen të depozitojnë kundrejt pagesës në *landfill* -et e licencuara mbetjet inerte, duke përfshirë edhe dherat e zakonshëm të pa kontaminuar që vijnë si rezultat i gërmimit. Këto janë mbetje që nuk pësojnë trajtim nga landfillet, përkundrazi bëhen burim rishitje dhe përfitimi të ri prej tyre në rast kur nevojiten për procese mbushje ose landscape (pra duke u ri-paguar blerja e tyre nga ana e shoqërive ndërtuese që mund të kenë paguar paraprakisht për dorëzimin e tyre).

#### **5. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Sipas parashikimeve aktuale të Ligjit “Për taksa dhe tarifat vendore”, por edhe në bazë të projektligjit “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme” objektet ndërtimore (edhe të paregjistruar) dhe trualli janë subjekt taksimi, përfshirë edhe sipërfaqen ndërtimore që janë stok i pa shitur, për të cilat theksojmë se:

- Objekti i taksueshëm janë pasuritë e paluajtshme, të cilat identifikohen sipas dokumenteve të pronësisë. Në praktikën aktuale, në rastet e zhvillimeve ndërtimore, trualli mbi të cilin po zhvillohet një objekt me leje ndërtimi është subjekt i taksës mbi truallin/tokën bujqësore deri në momentin që do të pajiset objekti me certifikatë pronësie, i cili transformohet në prona ndërtesë, subjekt të taksës për ndërtesën. Pra potencialisht, zhvilluesi që ndërton mbi truallin në pronësinë e tij e paguan taksën e truallit/ndërtesës deri në ditën që objekti regjistrohet në ASHK në emër të klientit.
- Karakteri dhe përmbajtja e së drejtës së pronësisë në kuptimin juridiko -civil është sanksionuar në nenin 149 të Kodit Civil, sipas të cilit “*Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijeve të caktuar nga ligji*”. Nga kjo dispozitë, si dhe nga përmbajtja e neneve 296, 302, 304 të Kodit Civil rezulton se posedimi, gëzimi dhe disponimi janë tre tagrat (pushtetet) kryesore të pronarit.

Për sa me sipër, duket qartë se ligjvënësi në percaktimin e taksës mbi pronësinë e paluajtshme, e ka për qëllim të taksojë të drejtën e taksapaguesit për të gëzuar të drejtën e pronësisë. Në rastin e zhvillimit ndërtimor, subjekti zhvillues ka marrë angazhimin të transformojë truallin/tokën, e për rrjedhim ka përcaktuar një destinacion të pakthyeshëm dhe të ndryshëm nga ai aktual.

Në këto kushte, taksimi si truall/tokë bujqësore gjatë periudhës së ndërtimit kur prona definitivisht nuk mund të përdoret më sipas atij destinacioni, është një kosto e panevojshme dhe e pajustificuar që i ngarkohet zhvilluesit/ndërtuesit.

- Gjithashtu i njëjti aplikim i sforcuar i taksës së ndërtesës zbatohet edhe në rastin e objekteve të rezultuara nga ndërtimi me qëllim shitje, ku taksa aplikohet ndaj ndërtuesit deri sa këto objekte të kalojnë në pronësi të blerësit.



## 6. *Kompensimi i variacionit të çmimeve*

Tjetër problematikë shqetësuese është edhe luhatja e ndjeshme e çmimeve të materialeve të ndërtimit në tregjet ndërkombëtare dhe ato kombëtare, ndaj të cilave sektori ndërtimit ekspozohet tërësisht në rezikun e tij veçanërisht në kontratat e punëve publike.

Në konkluzion të sa më sipër vlerësojmë se, vullneti i qartë i qeverisë për të rritur gjithmonë e më shumë barrën fiskale dhe tatimore në sektorin e ndërtimit, me qëllimi për të përfituar sa më shumë kontribut në buxhet nga një prej sektorëve më domethënës të ekonomisë në vend, përbën në vetvete një levë anti-produktive për të shtyrë strategjinë e zhvillimit të sektorit turistik dhe rrjetit infrastrukturor në vend, si dhe rrezikon zhvillimin e mëtejshëm në terma cilësorë, dhe pse jo jetëgjatësinë e këtij sektori

Konkretisht aktorët kryesor që po angazhohen në punimet e infrastrukturës sipas marrëdhënieve koncesionare dhe krijimin e strukturave të reja turistike, mbështeten në subjekte tregtare/investitor të cilët aktivitet kryesor kanë ndërtimin e objekteve civile.

Pra, duke kufizuar resurset e subjekteve ndërtues në mënyrë direkte, do të kufizohen edhe mundësitë e investimit nga sektori privat në strategjitë sektoriale të qeverisë.

Gjithashtu theksojmë se, rritja e kostove do të kufizojë edhe iniciativa për inovacion dhe aplikimin e teknologjive të reja me impakt të kufizuar në mjedis dhe shëndet njerëzor në këtë sektor.

**Ne vijim të sa më sipër**, ju parashtrojmë disa sugjerime në lidhje me lehtësimin e peshës fiskale kundrejt sektorit të ndërtimit me objektiv një trajtim të ekuilibruar dhe të drejtë, duke shpresuar konsiderimin nga ana Juaj:

### **SUGJERIM 1: Çmimi i referencës të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”**

**Sugjerojmë se:** Nëse, pavarësisht të gjithë problematikës që sjell rritja e kostos në prodhim edhe në gëzim të pasurisë së paluajtshme në një moment të vështirë ekonomik global, nga ana e qeverisë do të vijohet me zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 26.7.2023, propozojmë që *hyrja në fuqi të jetë graduale ose aplikueshemria kundrejt zhvilluesve të lidhet vetëm me projekte që nisen dhe përfundojnë pas hyrjes në fuqi të vendimit.*

### **SUGJERIM 2: Kontributi për Strehimin Social**

**Sugjerojmë se:** Duke qenë se ky ligj, në këndvështrimin tonë, bie në kundërshtim me Kushtetutën, sugjerojmë shfuqizimin e tij.

### **SUGJERIM 3: Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë**



**SHOQATA E NDERTUESVE TE SHQIPERISE**  
**ALBANIAN CONSTRUCTORS ASSOCIATION**

Miratuar me Vendim Nr. 38 date 12.10.2001 te Gjykates se Tiranes  
Llogaria bankare, Banka Kombetare Tregtare, Dega 2, Tirane, Nr. 402002214

**Sugjerojmë se:** Taksa e ndikimit në infrastrukturë, përveçse duhet të rishikohet në aspektin e shkallës tatimore të aplikuar, në veçanti në Tiranë, ku identifikojmë si më të përshtatshëm rangun nga 2-6%, mënyra e llogaritjes së saj propozojmë të jetë e orientuar edhe drejtë kostos. Pra, vlera e taksës propozojmë të llogaritet mbi koston e ndërtimit dhe jo mi vlerën e referencës së shitjes, në mënyre që të përputhet me qëllimin që ligjvënësi i ka dhënë taksës. Vlera e taksës mund të mbledhet sipas fazave të kontroleve të zbatimit.

*Gjithashtu sugjerojmë se, në rast se në kuadër të ndërtimit, ndërtuesi do të kryejë investime në infrastrukturë në përfitim të publikut (pra që asetet kalojnë përfundimisht në dobi të ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe të shpërndarjes së energjisë eklektrike), këto kosto të dëshmuara me fatuara përkatëse tatimore duhet të zbriten nga vlera e taksës ose të njihen si kredi tatimore.*

**SUGJERIM 4: Trajtimi i padrejtë i mbetjeve inerte**

**Sugjerojmë se:** Katalogu i mbetjeve të rishikohet në përputhje me Direktivën Europiane 2008/98/EC dhe të përjashtohet nga pagesa trajtimi i dherave të zakonshme (të pakontaminuar).

**SUGJERIM 5: Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

**Sugjerojmë se:** Të kryhet një rishikim ndersektorial i Projektligjit të ri, pasi taksa në formën që është konceptuar në Projektligjin e ri, paraqet shume paqartësi për formën e llogaritjes, aplikimit dhe mbledhjes së saj. Në aspektin e aplikimit kundrejt zhvillueseve/ndërtueseve **sugjerojmë që** të aplikohet një pezullim tatimor për periudhat në të cilat trualli është në zhvillim e sipër sipas afatit të lejes dhe ndërtesat e regjistruara në emër të zhvilluesit si pasojë e një procesi ndërtimi të jenë të përjashtuara deri në momentin e shitjes ose hedhjes në qarkullim me qira nga vetë ndërtuesi.

**SUGJERIM 6: Kompensimi i variacionit të çmimeve**

**Sugjerojmë se:** Në kuadrin ligjor për prokurime publike; koncesionin; PPP, të **adaptohen parashikime ligjore sipas së cilave, në rast të luhatjeve të ndjeshme të çmimeve** në tregjet ndërkombëtare dhe ato kombëtare, të bëhet njohja e variacioneve të çmimeve, ashtu sikurse parashikohet në librat e verdhë dhe të kuq të "FIDIK" për të gjitha kontratat e punëve publike, qofshin ato me financime të buxhetit, organizatave apo financimeve të huaja.

Për sa me sipër, ju ftojme që të merrni në konsideratë rishikimin e strategjisë së qeverisë e cila është orientuar tërësisht drejt rritjes së barrës fiskale dhe tatimore të sektorit të ndërtimit.

Ju ftojme që te organizojmë një tryezë të përbashkët diskutimi me aktorët e përfshirë në këtë sektor të ekonomisë, ku mund të hedhim propozime konkrete edhe palë të tjera të cilat mund të udhëhiqen më pak nga interesa të drejtpërdrejtë ekonomik, por në një këndvështrim më të gjerë të zhvillimit sektorial.

Me respekt.

**KRYETARI I SHOQATËS SË NDËRTUESVE TË SHQIPËRISË**

**ERJON HARIZI**

